

KËRKESË

Nr. 3521/3, datë 20.2.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen “Çlirimi”, Lushnjë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 203,381 (dyqind e tre mijë e treqind e tetëdhjetë e një) lekë.

ZËVENDESMINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

“SISTEMIMI I BLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN “ÇLIRIMI”, LUSHNJË”

Vlera e shpronësimit të z. Ibrahim Gega

Investitori: Bashkia Lushnjë

Vlera totale e shpronësimit: 203,381